

VENDIM
Nr.196, datë 5.4.2006

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE
PËR KURIMIN E ZNJ. RUSHEM GOLEMI NË ITALI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 8 e 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, zëri “Shpenzime për mallra e shërbime”, t’i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, për përballimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e znj. Rushen Golemi në Itali.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Pagesa të kryhet pas paraqitjes së faturave të shpenzimeve të kurimit.
4. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha